

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“TRUTH” sh.p.k

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarin dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Q.K.R”, të ndryshuar me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur dhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, ortakët :

Mateos Toçi, i biri Ilirian Toçi, i datëlindjes 16.05.1993, me numër personal të kartës së identitetit J30516074E banues në Elbasan, me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Vahit Sula, i biri i Ramazan Sula, i datëlindjes 21.04.1953, me numër personal të kartës së identitetit F30421005E banues në Elbasan, me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Sulejman Cani, i biri i Ali Cani, i datëlindjes 13.01.1959, me numër personal të kartës së identitetit F90113045M banues në Elbasan, me zotësi të plotë juridike për të vepruar



Sot me datë 03.11.2023, krijojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, redaktojnë dhe nënshkruajnë Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “**TRUTH**” sh.p.k e cila do t’i nënshtrohet këtij Akti Themelimi, Statutit të miratuar dhe legjislacionit Shqiptar ne fuqi, me akt themelimi si vijon:

Neni 1


Emërtimi

Formohet Shoqëria me përgjegjësi kufizuar e quajtur “**TRUTH**” sh.p.k

Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.



1



Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Neni 2

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Nr. Pasurie 7/32, ZK 8521, Elbasan.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

Bar-Kafe. Lounge. Muzike Live . Organizim Eventesh

Për të realizuar objektin e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj

Neni 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkakut të parashikuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

2

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ortaku zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Pjesmarrja secilit nga ortakët në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

Ortaku z. Mateos Toçi: zotërues i ____ 1 (një) ____ kuote me vlerë 34.000 lekë, që përbën 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku z. Vahit Sula: zotërues i ____ 1 (një) ____ kuote me vlerë 33.000 lekë, që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku z. Sulejman Cani: zotërues i ____ 1 (një) ____ kuote me vlerë 33.000 lekë, që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut është në para.

Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer dhe nënshkruar tërësisht nga ortaku i shoqërisë.

Neni 6

Drejtimi i Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:




1. Asambleja e Ortakëve
2. Administrimi

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, i cili është dhe përfaqësuesi ligjor i saj.

Administratori është përfaqësues i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj, me përjashtim të kompetencave të cilat i ka Asambleja e ortakëve sipas përcaktimeve në Statut.

Administrator i parë i shoqërisë, me një afat 5 vjeçar nga data e regjistrimit në QKB, është

Z. Mateos Toçi me numër personal të kartës së identitetit J30516074E .



Ortakët në momentin e firmosjes së këtij akt themelimi, deklarojnë se i njohin detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008, të ndryshuar, dhe në veçanti përcaktimet e neneve 13, 17 dhe 206 e vijues të këtij Ligji.

Me këtë akt themelimi ngarkohet administratori të kryejë veprimet e nevojshme në Bankat e nivelit të dytë.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve.

Neni 8

Asambleja e ortakëve ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë. Ka të drejtë të caktojë financierë, likuidatorë për problemet e shoqërisë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Çështjet që nuk trajtohen në këtë akt themelimi rregullohen në Statut dhe në legjislacionin shqiptar.

Neni 12

Akti i themelimit u përpilua në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje, dy kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe dy kopje do të mbeten në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES

“TRUTH” sh.p.k

Mateos TOÇI

Vahit SULA

Sulejman CANI

MATEOS TOÇI

Vahit Sula

Sulejman Cani

Sula

Can